AGRO TECH 2018

EXPO & KONFERENCË
27 - 29 Prill 2018

PANAIRI DHE KONFERENCA E PARË NDËRKOMBËTARE

E AGROBIZNESIT DHE AGROTEKNIKËS
27 - 29 Prill 2018
në Expocity Albania
Tiranë, Shqipëri

NA GJENI NË:

WWW.EXPOCITY.AL

EXPOCITY ALBANIA

ufi Member

PROJEKTI

Panairi i Parë Ndërkombëtar për sektorët e Agrobiznesit dhe Agroteknikës, organizuar nga Expocity Albania, do të mbahet në 27-29 Prill 2018. Qëllimi kryesor i panairit është të mbledhi të gjithë aktorët më të rëndësishëm në fushat e bujqësisë dhe agroteknikës në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit, në një ambient unik. Ne synojmë të krijojmë një platformë ndërkombëtare të komunikimit për fermerët dhe prodhuesit bujqësor nga i gjithë vendi, si dhe të paraqesim një mundësi të shkëlqyer për të lidhur dhe krijuar kontakte të drejtëpërdrejta me kompanitë më të mëdha të kësaj industrie, në të gjithë rajonin.

NË BASHKËPUNIM ME:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

STATISTIKA 2016

Eksportet e produketeve bujqësore në % me totalin

- % 1.3 - Patate
- % 53.8 - Domate
- % 4.3 - Qepë
- % 22 - Bostan
- % 7.6 - Fruta
- % 1.6 - Grurë
- % 9.4 - Bimë Medicinale

OBJEKTIVI

Synimi kryesor i këtij panairi është krijimi i një mjedisi të përshtatshëm dhe tërheqës për të gjithë ekspozuesit, për të promovuar me sukses produktet dhe kompanitë e tyre, për të krijuar partneritete dhe për të marrë informacion mbi zhvillimet më të fundit në teknologjinë agrare, si dhe pjesëmarrjen në konfrencë dhe workshop-e të specializuara për biznese dhe institucione, të cilat kontribuojnë në fushën e agrobiznesit dhe teknikave bujqësore.
Konferenca Agro-Tech do të ofrojë praktikat më të mira për të përfituar nga subvencionet e qeverisë dhe nga Programi i Zhvillimit Rural i BE, duke ofruar zgjidhje të avancuara në përmirësimin e konkurrencës në bujqësi, menaxhim të qëndrueshëm të burimeve natyrore, aktivitete për mbrojtjen e klimës si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale. Konferenca do të prezantojë studime të rasteve, prezantime në panele dhe workshop-e, në përpjekje për të edukuar tregun drejt zhvillimeve me të avancuara të sektorit.

BUJQËSIA NË SHQIPËRI

Bujqësia është në qendër të rritjes ekonomike të Shqipërisë si një sektor që gjeneron rreth 17.7% të GDP-së së vendit dhe siguron punësim në rreth 50.7% të popullsisë, duke kontribuar në zbutjen e varfërisë dhe në rritjen e standardeve të jetesës, veçanërisht në zonat rurale. Kërkesa në rritje për ushqim të shëndetshëm, të qëndrueshëm dhe të prodhuar në mënyrë organike rrit nevojën për përshtatje me teknologjitë më të fundit dhe zgjidhje më efikase dhe efiçiente për transformimin e biznesit bujqësor, me qëllim rritjen e produktivitetit dhe përmbushjen e të gjitha nevojave të tregut.

PROFILI I VIZITORIT

- Fermerët, Prodhuesit,
- Prodhues Sera, Prodhues Bujqësor
- Blerës potencialë të bujqësisë, Agjentët, etj.
- Autoritetet e Zhvillimit të Kooperativave Bujqësore
- Kompanitë Eksportuese të Makinerive Bujqësore
- Distributorët Rajonale të Kompanive Importuese
- Shoqatat Tregtare të Bujqësisë
- Investitorët e Huaj

PSE DUHET TË MERRNI PJESË NË AGRO-TECH

▸ *Si Ekspozues*

- Forcimi i lidhjeve ekzistuese midis bizneseve dhe institucioneve
- Prezantimi i kompanisë / institucionit dhe përmirësimi i imazhit në treg
- Informohuni për politikat e reja bujqësore
- Mundësi për tu bërë pjesë e një tregu të fuqishëm blerës për agrobiznes dhe produktet bujqësore
- Takime B2B dhe B2C
- Informohuni mbi tendencat e fundit dhe zgjidhjet më të mira teknologjike
- Monitorimi i konkurrencës dhe zhvillimeve të tregut
- Promovimi përpara mediave

▸ *Në Konferencë*

- Informohuni për politikat e reja bujqësore të qeverisë
- Informohuni për zgjidhjet më të fundit dhe më të efektshme të teknologjisë
- Informohuni për programet e reja financiare për sektorët e bujqësisë
- Informohuni për tendencat në tregjet vendore dhe ndërkombëtare
- Informohuni për mundësitë e investimit

Ekspozuesit:

A *Kompanitë bujqësore të prodhimit:*

- Fara, Inpute bujqësore Plehra;
- Pesticide dhe agro-kimike;
- Sera; Hortikulturë;
- Agrobioteknologji;
- Lule, bimë medicinale dhe dekorative;
- Pajisje dhe vegla Bujqësore;

B *Makineri bujqësore:*

- Pajisje dhe teknologji për përpunimin e ushqimit, paketimin, etiketimin;
- Pajisje për kontrollin dhe monitorimin e cilësisë
- Pajisje mbjellëse
- Hapëse dhe grirëse
- Pajisje për korrje dhe ujitje

C *Pjesëmarrës të tjerë:*

- Shoqatat bujqësore
- Ndërmarrjet e përpunimit të prodhimeve
- Institucionet financiare
- Institucionet qeveritare

AGRO TECH 2018

EXPO - CONFERENCE
27 - 29 PRILL 2018

@ EXPOCITY ALBANIA

Autostrada Tiranë - Durrës, km 8, Tiranë, Shqipëri

Na kontaktoni për të marrë detaje të plota rreth panairit dhe kushteve të pjesëmarrjes:

Drilona XHELAJ
Project Manager

+355 67 20 20909

drilona.xhelaj@expocity.al

KONFERENCA

Gjatë tre ditëve të panairit, konferenca mbi Bujqësinë do të mbahet për t'u përqëndruar në tematikat e ndryshme që mbulojnë fushat kryesore të interesit për Bujqësinë dhe Agro-Teknologjinë. Konferenca do të ofrojë mundësi për shkëmbimin e pikëpamjeve, për të fituar informacion mbi risitë në treg dhe për vendimmarrësit në nivel kombëtar, për të paraqitur planet zhvillimore të qeverisë. Temat e konferencës dhe workshop-et e ndryshme dhe takimet B2B, do të trajtojnë çështjet aktuale në industri dhe do të ngrejnë pyetje, duke prezantuar zgjidhje të reja dhe eficiente. Qëllimi është të prezantohen tendencat e fundit në treg dhe të rritet ndërgjegjësimin për mundësitë më të mira për një zhvillim të qëndrueshëm në industrinë e agrobiznesit.

TEMAT E KONFERENCËS

- Mbështetje Financiare për prodhuesit bujqësorë
- Kriteret e Financimit dhe Kreditimit në Bujqësi
- Konsulencë dhe zgjidhje financiare për kompanitë që veprojnë në fushën e Agrobiznesit
- Integrimi i teknologjive më të përparuara në prodhimin bujqësor
- Siguria e Ushqimit
- Zhvillimi i Prodhimit Biologjik (Histori Suksesit)

EXPOCITY ALBANIA

Expocity Albania është organizues i Panaireve dhe Konferencave Ndërkombëtare, i certifikuar nga UFI, specializuar në organizimin dhe zhvillimin e panaireve, ekspozitave dhe evente biznesi të ndryshme, drejtuar tregut vendor dhe atij ndërkombëtar. Expocity Albania ju ofron pjesëmarrësve në panaire platformën më të mirë të mundshme për komunikim të suksesshëm. Ne bashkojmë ofertën dhe kërkesën dhe mundësojmë dialogun, duke i dhënë bizneseve një mundësi për të promovuar produktin dhe shërbimet e tyre.